

## PËRMBLEDHJE JOTEKNIKE PËR AKTIVITETIN: MENAXHIMI I MBETJEVE

**ID 5.5**

**Magazininim i hekurishteve/skrapeve të metalit që nuk përmbajnë materiale të rrezikshme.**

*Sipas shtojcës 1 të Ligjit 52/2020 "Për disa ndryshime në ligjin nr.10448, datë 14.07.2011, të ndryshuar")*



<b>SUBJEKTI:</b>	<b>ELIS LENA</b>
<b>NIPT:</b>	<b>L22201008A</b>
<b>VENDNDODHJA:</b>	<b>Tiranë, Vaqarr, Objekt i hapur pranë Logjistikës.</b>

## 1. PROFILI I OPERATORIT

Subjekti **ELIS LENA** është i regjistruar në QKB si **Person Fizik** me Nr.NIPT **L22201008A**.

Fusha e veprimtarisë së operatorit konsiston në Grumbullim skrapi dhe grumbullim metali me ngjyre.

**Subjekti kërkon të aplikojë për leje mjedisi Tipi B për aktivitetin:**

### MENAXHIMI I MBETJEVE

<b>ID 5.5</b>	<i>Magazininim I hekurishteve/skrapeve të metalit që nuk përmbajnë materiale të rrezikshme.</i>
---------------	---

*Referuar shtojces 1 te ligjit 52/2020 "PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.10448, DATË 14.7.2011, "PËR LEJET E MJEDISIT", TË NDRYSHUAR.*

## 2. OBJEKTIVAT E AKTIVITETIT:

- Objektivi i pare i ketij aktiviteti do te jete te identifikojë ndikimet e mundshme negative mjedisore si:
  - Emetimet ne ajer dhe zhurmat;
  - Ndikimi ne flore/faune;
  - Mbetjet e gjeneruara nga aktiviteti i punetoreve;
  - Ndikime social-ekonomike;
  - Ndikim ne cilesine e jetes ne qendrat e banuara;
  - Ndikim ne peizazhin e zones;
- Objektivi i dyte i ketij aktiviteti eshte gjetja e alternativave qe jane me miqesore me mjedisin.

### 3. VENDODHJA E AKTIVITETIT

Vendi në të cilin do të zhvillohet aktiviteti që do të kryejë subjekti ndodhet në adresën:  
Tiranë, Vaqarr, Objekt i hapur pranë Logjistikës.

Koordinatat e vendndodhjes se aktivitetit janë si më poshtë:

Nr.	X	Y
1.	4395610.44	4575398.56



#### 4. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

##### 1. PROCESI TEKNOLOGJIK

Per sa i perket menyres se funksionimit te aktivitetit eshte nje praktike shume e thjeshte, e cila ndihmon ne menaxhimin e integruar te mbetjeve. Regjimi i punes ne aktivitetin ne fjale kryhet vetem me nje 1 turn, e cila konsiston ne disa hapa fare te thjeshte.

Grumbullimi, seleksionimi, magazinimi i skrapeve te metalit do të kryhet sipas VKM-së nr.660, date 31.10.2018 "Për miratimin e kerkesave per menaxhimin e mbetjeve te metaleve".

Skrapi sigurohet nga furnitore te ndryshem dhe do te sistemohet sipas llojit. Materialet do te grumbullohen dhe do te shkarkohen ne sheshin e dedikur per materialet skrap jo te rrezikshme. Keto materiale do ti nenshtrohen procesit te seleksionimi.

Theksojme se ne objekt nuk do te kemi riciklim te skrapit apo mbetje te tjera, por vetem shitje me shumice, kompanive ricikluese. Aty eshte instaluar edhe nje peshore, qe do te sherbeje ne momentin e shitjes per te peshuar sasine e ardhur apo te dale nga furnitoret dhe klientet. Per cdo sasi te dale dhe per cdo sasi qe do te hyje ne objekt, do te mbahen regjistrat e vecante te tyre.

Territori dhe ambjenti do te qendroje gjithmone paster, e i sistemuar.

Do te mirembahet me kujdes rrjeti i brendshem i furnizimit me uje dhe energji elektrike si dhe sistemi kullues dhe dekantues i ujerave te shiut.

Do te respektohen rigorozisht rregullat higjieno-sanitare dhe te sigurimit teknik te punonjesve te subjektit dhe nuk do te ushtrohet asnje ndikim negativ ne shendetin e popullates qe banon perreth subjektit.

##### PERSHKRIMI TEKNOLOGJIK I METEJSHEM

Aktiviteti si veprimtari kryesore ka magazinimin e hekurishteve/skrapeve te metalit, ky aktivitet konsiston ne magazinimin e hekurishteve/skrapeve te metalit ne fund te jetes dhe tregetimin e tyre per pjese.

Pajisjet jane bashkekohore dhe te lehta ne perdorim dhe manovrim, nuk ka clirime të gazrave apo shkarkime të tjera të dëmshme të rrezikshme e me natyrë ndotjeje. Do te merren keto mbetje dhe do te cmontohen sipas llojeve te skrapit dhe me pas do ju shiten subjekteve ose individeve te interesuar dhe qe kane nevojte per keto lende/pjese. Per te realizuar punimet dhe veprimet e mesiperme nevojiten:

- Ndarja e pjeseve te skrapit.
- Per ndarjen mund te nevojiten vegla pune mekanike etj.

Kapaciteti i proketuar i magazinimit te hekurishteve/skrapeve te metalit eshte:

- Magazinim i 50 tone skrap ne dite

Subjekti ka per qellim magazinimin hekurishteve/skrapeve te metalit dhe keto jane disa nga fazat e punes ne kete aktivitet:

### Faza 1 Depozitimi i skrapeve te metalit

Ne momentin qe lenda e pare vjen ne subjekt ajo depozitohet ne sheshin e percaktuar paraprakisht, ku me pas do te behet ndarja dhe seleksionimi sipas llojit te skrapeve qe mund te jene mbetje te pastra te perbera vetem me nje lidhje celiku, hekur, qe mund te jene me nje ose me shume lidhje, tornitura, skorje etj.

### Faza 2 Seleksionimi dhe ndarja

Pas depozitimit se skrapeve te ndryshme te metalit ne aktivitet behet demontimi manual i pjesëve të ndryshme të makinave, pajisjeve jashtë përdorimi, seleksionimi i tyre dhe ndarja sipas llojit, per kete proces nevojiten vegla pune mekanike.

### Faza 3 Magazinimi


Ne subjekt behet magazinimi sipas llojit te skrapit te ardhura ne subjekt nga kliente te ndryshem.

Ne baze te ketyre fazave subjekti kryen keto sherbime;

- Ndarja e pjeseve te skrapit ne pjese te vecanta
- Dhe se fundmi shtypja dhe pergatitja per shitje e tyre tek subjektet e interesuara, pergjithesisht kompanive qe merren me riciklimin e mëtejshëm te pjesëve metalike jo te perdoreshme.

#### 4.1. Menaxhimi I instalimit

##### ORGANOGRAMA



**Tabela e meposhteme jep informacion mbi kushtet e punes.**

<b>KUSHTET E PUNËS</b>					
Numri total i punonjësve	<b>4</b>				
Shpërndarja e punonjësve	<b>ZYRA</b>	<b>PRODHIMI</b>	<b>MIRËMBAJTJA</b>	<b>MAGAZINIMI</b>	<b>TË TJERA</b>
	<b>1</b>	<b>-</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>-</b>
Turnet dhe aktivitetet	Zyrat/Administrata		Instalimet		
	08 <sup>00</sup> -16 <sup>30</sup>		08 <sup>00</sup> -16 <sup>30</sup>		
Orët e punës	Zyrat/Administrata		Instalimet		
	8 orë/ditë		8 orë/ditë		
Numri i ditëve të punës në vit	<b>312 ditë/vit</b>				
Numri i orëve në vit	<b>312 ditë x 8 orë = 2496 orë/vit</b>				
Variacionet sezonale	<b>Nuk preket nga variacionet sezonale</b>				
Turnet dhe numri i punëtorëve për turn	Gjatë variacioneve sezonale		Pjesa tjetër e vitit		
	Nuk ka		1 turn → 08 <sup>00</sup> -16 <sup>00</sup>		
Periudhat gjatë të cilave kompania mbyllet	Pushimet		Dita e dielë është pushim. Gjithashtu sipas kodit të punës, punëmarrësve u takojnë 24 ditë/pune pushimi në vit.		
	Ndërprerje të rregullta të funksionimit		Dita e dielë.		

#### **4.2. Lëndët e para dhe ndihmëse**

\*\*\*Aktiviteti nuk është një aktivitet i mirefillte prodhimi, por si lende e pare për funksionimin e tij mund të çilesohen metalet e skrapit/hekurishtet.

<b>Lëndë të para</b>	<b>Lëndë/Materiale ndihmëse</b>
Metale/skrape	Ujë
--	Energji elektrike
	Presa, seleksionuesi.

## 5. IDENTIFIKIMI DHE VLERESIMI I SHKARKIMEVE DHE NDIKIMEVE NE MJEDIS

Mjedisi eshte gjithmone i prekur nga veprimtarite e ndryshme qe ushtrohen ne te, por ndikimi mund te jete i ndryshem, kjo eshte e lidhur ngushte me vete llojin e veprimtarise, e cila mund te kete impakt te drejtperdrejte, te terthorte, te rendesishem apo mesatar i pranueshem. Nga zhvillimi I aktivitetit pritet qe te kete ndikime minimale ne mjedis, duke iu referuar edhe natyres se tij. Disa nga shkarkimet e mundshme te ketij aktiviteti jane si me poshte vijon:

<b>Rrezatimi Jonizues</b>
Nga zhvillimi i aktivitetit nuk kemi rrezatime jonizuese.
<b>Vibracionet</b>
Zhvillimi i aktivitetit nuk do te shoqerohet me gjenerim te vibracioneve.
<b>Ndikimet ne popullsi</b>
Zhvillimi I aktivitetit nuk do te kete ndikime ne levizjen apo zhvendosjen e popullsise se rajonit, por mund ta quajme nje impact pozitiv pasi do te punesohen individe te zone. Zonat e banuara kane nje distance relativisht te konsiderueshme duke qene keshtu te mbrojtur nga ata pak ndikime nevatie qe mund te shfaqj aktiviteti.
<b>Ndikimet ne toke</b>
Ne kete aktivitet nuk mund te kemi ndikime ne toke per aq kohe sa operatori ploteson te gjithe standartin per zhvillimin e aktivitet. Aktivitete te tilla ndihmojne ne miremanxhimin e mbetjeve dhe jane shume te rendesishme duke u shoqeruar me nje impakt pozitiv si nderlidhes te kompanive ricikluese.
<b>Mbetjet e ngurta</b>
Mbetjet e ngurta qe dalin si rezultat i aktivitetit te punonjesve do te grumbullohen ne vendet e caktuara nga shoqeria dhe me pas do te dergohen per ne vendet e caktuara nga pushteti vendor. Do te punohet qe keto mbetje te ndahen qe ne burim dhe do te perdoren kontiniere hermetike qe te evitohen aromat e pakendeshme qe mund te vijne si pasoje e kushteve klimaterike.
<b>Ndikimet ne ajer</b>
Aktivitete te tilla nuk shoqerohen me ndikime ne ajer. Ndikime te vetme te cilat do te quhen ndikime ne ajer jane nga levizja e mjeteve brenda aktivitetit. Keto ndikime jane mese normale dhe teresisht te menaxhueshme. Mjetet do te qendrojne per nje kohe shume te shkurter ne vendndodhje, por perpos kesaj ato do te fiken gjate priudhes se shkarkimit te skrapit. Ndikime te tjera ne ajer nuk kemi.
<b>Ndikimet ne ujera</b>
Ky aktivitet nuk perdor uje gjate procesit te punes qe ai kyen keshtu qe nuk ka shkarkime ne ujera.
<b>Ndikimet ne klime</b>
Gjate zhvillimit te aktivitetit nuk priten ndryshime te dukshme klimaterike, si ne drejtim te permiresimit ashtu edhe ne ate te perkeqesimit te saj. Nuk do kete ndryshime ne temperature, ne drejtim te eres, ne sasine e reshjeve. Pra kryerja e ketij aktiviteti nuk ndikon fare ne kushtet klimaterike te kesaj zone.
<b>Ndikimet ne floren dhe faunen</b>
Zona në te cilen ushtrohet aktiviteti është një zonë në të cilën nuk takohen elemente te spikatur te flores. Perreth kësaj zone, mund te hasim bimesi te ulet dhe barishte te

ndryshme. Aspekti faunistik i lidhur ngushte me mjedisin rrethues ketu paraqet nje larmi biologjike te varfer. Zhvillimi i ketij aktiviteti nuk paraqet asnje ndikim negativ ne flore apo faun.

#### **Ndikimet nga zhurmat**

Aktiviteti qe zhvillon subjekti, eshte nje aktivitet i cili mund te shoqerohet me gjenerime te lehta zhurme por te cilat jane te monitorueshme dhe te menaxhueshme. Zhurma do te kemi gjate procesit te punes sidomos ne kohen kur do te shkarkohen ngarkesat por eshte nje gjenerim momental dhe zgjat vetem disa minuta. Per sa i perket gjenerimeve nga burime te tjera do te jene ne vlera normale krahasuar me aktivite te po te njejtës natyre.

#### **Ndikimet e aktivitetit te zhvillimit ne rrugët lokale dhe transportin**

Gjatë zbatimit të aktivitetit nuk do kete ndryshime të rrjetit të rrugëve lokale dhe transportit. Gjithashtu nuk eshte e nevojshme devijimi apo hapja e ndonje rrjeti te ri infrastrukturor.

#### **Ndikimet e aktivitetit te zhvillimit mbi ndertimet, trashegimine arkitektonike historike dhe zonat e mbrojtura**

Aktiviteti që ushtron shoqeria zbatohet në një zonë në sipërfaqen e së ciles dhe në nëntokën e saj nuk ka ndertime lidhur me trashegimine arkitektonike dhe historike, tiparet arkeologjike, si dhe mbi vepra te tjera njerezore. Kjo tregon që zona është zonë e lirë jo vetëm për të realizuar kete aktivitet, por njëkohësisht një zonë në të cilën aktiviteti nuk shoqerohet me pasoja ndotëse për mjedisin.

#### **Ndikime ne rrjetin hidrografik**

Aktiviteti qe zhvillon subjekti nuk ka ndikime ne rrjetin hidrografik. Zona ne te cilen zhvillohet nuk takon elemente te spikatur hidrologjik si pershembull lumenj etj.

#### **Ndikimi social-ekonomik**

Me operimin e ketij aktiviteti pritet te kete nje impakt pozitiv ne ekonomine e vendit. Operatori do te punesoje personel te zones, duke bere te mundur rritjen ne nivelin ekonomik dhe te punesimit.

Ky aktivitet nuk pritet të ketë ndikim mjedisor të matshëm pasi:

- Nuk ka perpunim të mbetjeve as të rrezikshme as jo te rrezikshme;
- Këtij aktiviteti nuk do të ndikojë në ndryshimin e nivelit të ujrave tokësore, në rrugët ujore dhe në nivelin hidrostatik të ujrave nëntokësore, pasi në këtë zonë ku ndodhet objekti dhe përreth tij nuk ka burime ujore nëntokësore dhe shpime të ndryshme hidrogeologjike që do të mund të dëmtoheshin nga ky aktivitet.
- Nuk shkakton ndotje të tokës me shkarkime të ndryshme të lëngëta apo të ngurta.
- Gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti nuk do të ketë shkarkime të lëndëve ndotëse në ujë.
- Ushtrimi i këtij aktiviteti nuk do të ndikojë në cilësinë e ajrit të zonës, pasi nuk do të ketë shkarkime në ajër të gazrave, pluhurave apo tymrave.
- Zhurmat në mjediset e punës janë brenda normës sanitare të lejuar, dhe për pasojë as zhurmat në mjediset e jashtme nuk pritet të kenë ndikim në popullatën përreth. Niveli i zhurmës nuk i kalon 55-70 dBA gjate punes. Ky nivel zhurmash është brenda normave dhe nuk ndikon në shëndetin e punonjësve.



## 6. MASAT ZBUTESE DHE PARANDALUESE TE NDIKIMEVE NE MJEDIS

REKOMANDIMET	
<b>TOKA</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Kryerja e aktivitetit brenda koordinatave të përcaktuara</li> <li>➤ Zbatimi i kushteve teknike dhe standarteve</li> <li>➤ Menaxhimi sa më efektiv i mbetjeve, me qëllim mbrojtjen e mjedisit tokësor.</li> </ul>
<b>CILËSIA E AJRIT</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Larja dhe pastrimi i ambjenteve të punës periodikisht, në mënyrë që të eliminohen aromat.</li> <li>➤ Kontroll periodik i pajisjeve që përdoren për aktivitetin.</li> <li>➤ Përdorimi i mjeteve mbrojtëse për aparatet respirativ nga ana e punonjësve.</li> </ul>
<b>UJËRA</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Mirembajtja e vaskave dekantuese për një trajtim eficient.</li> <li>➤ Pastrimi i mjedisit në rast të shkaktimeve aksidentale</li> </ul>
<b>MENAXHIMI I MBETJEVE</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Vendosja e kontenerëve në brendësi dhe jashtë objektit.</li> <li>➤ Diferencimi i mbetjeve sipas fraksioneve të gjeneruara.</li> <li>➤ Transportimi periodik i tyre në vendepozitim më të afërt të caktuar nga njësi vendore.</li> </ul>
<b>NIVELI I ZHURMAVE</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Operimi brenda orareve të caktuara, nga rregullorja e punës.</li> <li>➤ Respektimi i gjitha rregulloreve gjatë procesit të punës.</li> <li>➤ Lëvizje e ngadaltë dhe e kujdesshme në ambjente të aktivitetit.</li> <li>➤ Vendosja e tabelave zbatimin e rregullores në ambjentet e aktivitetit në mënyrë rigoroze.</li> </ul>

## 7. MONITORIMI

Plani i monitorimit në mjedis do të konsistojë në:

Nr.	Elementi i monitorimit	Frekuenca	KUSH?
1.	Monitorim i cilësisë së ajrit	Cdo 6 muaj	L.Akredituar
2.	Monitorim i zhurmave	Cdo 6 muaj	L.Akredituar
3.	Monitorim i gjendjes teknike të pajisjeve operuese	Cdo 1 vit	Operatori/ teknike te posatshem

Person Fizik  
**ELIS LENA**  
 Elis LENA  
 NIPT L22201008A  
 TIRANE-ALBANIA